REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KRYETARI**

Nr.3150/4 Prot                                                                 Pogradec, më 21.08.2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**ZNJ. MANJOLA KAMOLLI**

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuara zonja Kryetare,**

Bashkëngjitur, po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025 – 2030, të Bashkisë Pogradec".

Me respekt,

**KRYETARI**

**Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 7

Nr. I faqeve të Planit Vendor të Barazisë Gjinore: 45

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:keshillibashkiakpogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr. ____ Prot                                                                 Pogradec, më ____ . ____ .2025

**PROJEKT – VENDIM**

**Nr. ____, datë ____.____.2025**

# "PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030 TË BASHKISË POGRADEC"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" neni 14; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 - 2030 dhe të planit të saj të veprimit"; Ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar; Ligjit Nr. 10221 datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar; Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, nënshkruar nga Bashkia Pogradec më 28.05.2020; Urdhërit të Kryetarit nr.18, datë 27.01.2025 "Për krijimin e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ)", si dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**VENDOSI:**

1. Të miratojë Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 – 2030 (PVVBGJ), të Bashkisë Pogradec.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, si dhe drejtori të tjera përgjegjëse sipas nevojës, Bashkia Pogradec.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETARE E KËSHILLIT**
**Manjola KAMOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:keshillibashkiakpogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KRYETARI**

Nr.3150/Prot /4 Pogradec, më 21.08.2025

**RELACION**

Në lidhje me Projekt - Vendimin "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025 – 2030, të Bashkisë Pogradec",

**E nderuara Kryetare e Këshillit!**

**Të nderuara/nderuar Këshilltare e Këshilltarë !**

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" neni 14; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 - 2030 dhe të planit të saj të veprimit"; Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar; Ligjin Nr. 10221 datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar; Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, nënshkruar nga Bashkia Pogradec më 28.05.2020; Urdhrin e Kryetarit nr.18, datë 27.01.2025 "Për krijimin e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ)", propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak, "Plani vendor i veprimit për barazinë gjinore 2025 – 2030" në Bashkinë Pogradec.

**Qëllimi** i këtij plani është të shërbejë si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, si dhë në përputhje dhe zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030", por edhe si një dokument që mundëson harmonizimin e veprimeve vendore me acquis të BE-së për barazinë gjinore, në rrugëtimin tonë si bashki, drejt integrimit evropian.

Ky dokument, i përgatitur nga Bashkia Pogradec përmes një procesi konsultues gjithëpërfshirës, ka të përcaktuar qartë vizionin, fushat kryesore të ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit, si dhe masat e veprimet që duhet të ndërmerren në këto vite për të përparuar drejt barazisë gjinore, si kusht për një zhvillim të qëndrueshëm.

I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

**Në vizionin** e PVVBGJ 2025 – 2030, theksohet se *"Gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Pogradecit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës".*

PVVBGJ, i bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe i konceptuar si një mjet për zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore[1], bazohet në këto parime themelore:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve , në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i steriotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

PVVBGJ 2025 - 2030 përbëhet nga ***katër fusha kryesore të ndërhyrjes***, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifikë të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

[1] Dokument i përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane, nënshkruar nga Bashkia Pogradec në datën 28.05.2020. Për më shumë shihni: https://charter-equality.eu/atlas-of-signatories-of-the-charter/signataires.html?send=ok&c_id=1&nh_id=0&ct_id=0

I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.
II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.
III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

*Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit e PVVBGJ 2025 – 2030 prezantohen në vijim*

***Fusha e ndërhyrjes I:****Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.*

*Rezultatet e pritshme:*

I.a. Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.

I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.

*Objektivat specifikë:*

I.1. Rritja e aksesit së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.

*Treguesit në nivel objektivi specifik:*

I.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit), etj.

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:keshillibashkiakpogradec@gmail.com

I.1.b. Numri i ndërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të rejat, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).

***Fusha e ndërhyrjes II:*** *Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.*

*Rezultatet e pritshme:*

II.a. Aktivitetet dedikuar pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendimmarrjen politike apo publike, adresojnë në mënyrën e duhur sfidat dhe steriotipet gjinore ekzistuese.

II. b. Veprimet që ndërmerr bashkia në këtë drejtim, nxitin zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe parimet e barazisë e gjithëpërfshirjes, veçanërisht për grupet më pak të përfaqësuara.

*Objektivat specifikë:*

II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin e tyre.

*Treguesit në nivel objektivi specifik:*

II.1.a. Numri i të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë përfunduar trajnime për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe për integrimin gjinor në vendimmarrje.

II.1.b. Përqindja e grave dhe të rejave drejtuese, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkiak, Njësitë Administrative, Këshillat e Fshatrave, etj.

***Fusha e ndërhyrjes III:*** *Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.*

*Rezultatet e pritshme:*

III.a. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe efikas.

III.b. Një brez i ri i barazisë, që lufton steriotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar.

III.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm.

*Objektivat specifikë:*

III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.

III.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore dhe promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".

*Treguesit në nivel objektivi specifik:*

III.1.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuara dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia.

III.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhunës me bazë gjinore.

III.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
III.2.b. Përqindja e grave, burrave, të rejave dhe të rinjve të përfshira/përfshirë në aktivitete që synojnë paqen, sigurinë dhe ndërtimin e komuniteteve të sigurta e gjithëpërfshirëse.

***Fusha e ndërhyrjes IV**: Integrimi gjinor në politikat vendore.*
*Rezultatet e pritshme:*
IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.
I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integrimi gjinor i reflektuar në politikat dhe planet e bashkisë.
*Objektivat specifikë:*
IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.
IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.
*Treguesit në nivel objektivi specifik:*
IV.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë dhe në Atlasin e Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).
IV.2.a. Numri i programeve buxhetore të analizuara nën këndvështrimin gjinor.
IV.2.b. Përqindja e buxhetit vjetor të bashkisë e dedikuar për zbatimin e PVVBGJ, dhe norma vjetore e rritjes së tij, krahasuar me përqindjen e buxhetit të shpenzuar për këtë qëllim.

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PVVBGJ 2025 - 2030 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2025 - 2030 janë në vlerën **14,938,905 lekë**. Nga këto:

- ***5,085,859 lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I "Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre".
- ***1,064,496 lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II "Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor".
- ***6,739,248 lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes III "Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje".

- **2,049,302 *lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV "Integrimi gjinor në politikat vendore".

Kosto financiare prej 14,938,905 (katërmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e pesë) lekë e nevojshme për zbatimin në tërësi të PVVBGJ 2025-2030 për të gjithë kohëzgjatjen e tij, do të përballohet respektivisht:

- 8,124,981 (tetë million e njëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) lekë nga fondet e bashkisë (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukturore ekzistojnë;
- 5,034,633 (pesë million e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë do të mbulohen nga donatorë të ndryshëm të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PVVBGJ-së),
- 1,798,791 (një million e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) lekë janë hendek financiar, për të cilat bashkia do të gjejë burime financuese, përmes donatorëve, organizatave të shoqërisë civile, etj., ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në Programet Buxhetire Afatmesme.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij plani si një mundësi e mirë për të realizuar objektivat e sipërshënuara dhe prioritetet e Bashkisë në lidhje me Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen Sociale.

**Faleminderit!**

Konceptoi: Ivana Capollari
Jurist: Klevisa Liçkollari
Konfirmoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR**
**Ilir XHAKOLLI**

BASHKIA POGRADEC

# PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2030

**Përgatitur nga Bashkia Pogradec**
**në kuadër të zbatimit të**
**Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030**
**si dhe**
**Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore**

Korrik, 2025

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030 u përgatit nga Bashkia Pogradec me mbështetjen e UN Women Shqipëri në kuadër të zbatimit të projektit: Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

**Grupi i punës:**

1. Entela Gusho, Nënkryetare - Kryetare
2. Manjola Kamolli, Kryetare e Këshillit Bashkiak - Anëtare
3. Ivana Capollari, Drejtore e Shërbimeve Sociale - Anëtare
4. Elda Pengu, Përgjegjëse e Sektorit të Përfshirjes Sociale - Anëtare
5. Arbi Basho, Specialist për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe barazisë gjinore (koordinator vendor) - Anëtar
6. Etleva Memia, Specialiste për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve - Anëtare
7. Blerta Çomo, Përgjegjëse e Njësisë për Integrimin Evropian - Anëtare
8. Irsa Karapança, Drejtore e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar - Anëtare
9. Erinda Kamolli, Drejtore e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike - Anëtare

**Ekspertiza teknike nga EU4GE II:**

1. Monika Kocaqi, Konsulente për integrimin gjinor dhe vetëqeverisjen vendore
2. Diamanta Vito, Konsulente për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe vetëqeverisjen vendore

© Bashkia Pogradec, 2025. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Sqarim:
Ky dokument përmban mendimet dhe pikëpamjet e shprehura nga autoret dhe autorët dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo organizmave të saj.

Të nderuara / nderuar qytetare e qytetarë të Pogradecit,

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030 është një dokument tepër i rëndësishëm i përgatitur përmes një pune të palodhur të stafit të institucionit që unë drejtoj, në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë edhe me anëtare dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak, përfaqësuese e përfaqësues të institucioneve vendore, Këshillit Vendor Rinor, shoqërisë civile, medias, si dhe me qytetare e qytetarë që u angazhuan për të dhënë komentet e tyre gjatë konsultimit publik.

Ky plan nuk është thjesht një dokument zyrtar, por është një shprehje e qartë e vullnetit tonë politik për të ndërtuar një qytet ku barazia midis grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, të mos jetë një premtim, por një realitet i integruar në çdo politikë, në çdo shërbim dhe në çdo nismë komunitare.

Përmes këtij plani, ne investojmë në fuqizimin ekonomik të grave, në mbrojtjen e të drejtave të vajzave dhe grupeve të cenueshme në promovimin e lidershipit të grave dhe të rejave e të rinjve, si dhe në sigurimin që buxhetet dhe vendimmarrjet tona vendore të pasqyrojnë nevojat specifike gjinore, si dhe karakteristikat e tjera individuale të të gjitha / gjithë qytetareve e qytetarëve, për të bërë të mundur që askush të mos mbetet pas.

Përparimi drejt barazisë gjinore nuk është dhe nuk duhet të konsiderohet si një mision vetëm i bashkisë, por si një rrugëtim i përbashkët që kërkon energjinë, zërin dhe angazhimin e secilës dhe secilit prej nesh, në qytet, në familje, në shkolla dhe në vendin e punës.

Falënderoj të gjithë aktorët vendorë, organizatat e shoqërisë civile, të rejat dhe rinjtë, grupet e grave dhe partnerët institucionalë që kontribuuan në hartimin e këtij plani. Falënderoj gjithashtu edhe UN Women dhe Bashkimin Evropian për mbështetjen dhe asistencën teknike në këtë drejtim. Së bashku, po ndërtojmë një Pogradec të mundësive të barabarta, e të gatshëm për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

Le t'i kthejmë këto angazhime në veprime konkrete dhe këto veprime në ndryshim të qëndrueshëm!

Me respekt dhe përkushtim,

Ilir Xhakolli
Kryetar
Bashkia Pogradec

## TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE....5
**I. HYRJE**....6
**II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL**....9
**III. METODOLOGJIA**....12
**IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË**....14
**V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025 - 2030**....178
**VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI**....21
**VII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030**....22

## LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

| | |
|---|---|
| AGK | Aleanca e Grave Këshilltare |
| AKPA | Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi |
| AZHBR | Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BGJ | Barazia Gjinore |
| CEDAW | Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| DHBGJ | Dhuna me Bazë Gjinore |
| DHF | Dhuna në Familje |
| ETN | Ekipi Teknik Ndërdisiplinar (për rastet e dhunës në familje) |
| EU GAP III | Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III |
| GTN | Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve) |
| KB | Këshilli Bashkiak |
| KBRE | Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës |
| LGBTI+ | Persona lezbike, gej, biseksuale/ë, transgjinore/ë, transseksuale/ë, interseks dhe cilëtdo persona të tjerë orientimi seksual dhe/ose shprehja e identitetit gjinor të të cilave/ëve është i ndryshëm nga heteroseksualet/ët. |
| MKR | Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| NBGJ | Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore |
| NJA | Njësi Administrative |
| NJVKSH | Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor |
| NJVV | Njësi e Vetëqeverisjes Vendore |
| OJF | Organizatë Jo-Fitim-Prurëse |
| ON | Organizatë Ndërkombëtare |
| OS | Objektiv Specifik |
| OSHC | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| PVVBGJ | Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore |
| SKBGJ | Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030) |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| ZVAP | Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar |

## I. HYRJE

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 - 2030 u përgatit nga Bashkia Pogradec, si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore[1].

Bashkia Pogradec e ka nënshkruar këtë dokument të rëndësishëm të përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane[2], në 28 maj 2020[3], duke ndërmarrë kështu një angazhim publik për të bërë realitet arritjen e barazisë gjinore në Pogradec. Ky angazhim shkon në përputhje dhe me detyrimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (objektivi specifik IV.3, aktiviteti IV.3.1.d.), me të gjitha standartet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe në respektim të plotësimit të kërkesave për integrimin në Bashkimin Evropian. Po në vitin 2020, Bashkia Pogradec miratoi Planin e parë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2020 – 2023.[4]

Zbatimi i këtij dokumenti, me masa dhe veprime konkrete, rriti dukshëm edhe performancën dhe punën e palodhur të stafit të Bashkisë Pogradec në lidhje me fuqizimin e grave, parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe hedhjen e hapave të qendrueshëm drejt barazisë e drejtësisë gjinore. Pozicioni i Nëpunësit të Barazisë Gjinore dhe Koordinatorit Vendor kundër dhunës në familje, prej vitesh i përcaktuar në organogramën e bashkisë, mbështetet gjithashtu edhe nga specialiste e specialistë të tjerë të Drejtorisë së Shërbimit Social në bashki, ndërkohë që bashkëpunimi me partnerët, sidomos institucionet vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe median, vlerësohet në një shkallë tepër të lartë. Si një ndër pesë bashkitë e para në vend që ka ngritur Mekanizmin e Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje, Bashkia Pogradec renditet gjithashtu ndër të paktat bashki në vend që administrojnë në strehëz emergjence, apo që kanë ndërmarë masa afirmative për fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, përmes lehtësimit nga tarifat vendore sidomos në nisjen e bizneseve nga ana e tyre, masa afirmative këto të miratuara në Këshillin Bashkiak, falë edhe propozimeve e lobimit nga Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian.

Si një qytet me tradita e kulturë, Pogradeci përmendet edhe për figurat e grave që kanë bërë histori ndër vite. Në një botim të përgatitur nga Bashkia Pogradec në vitin 2020 "Historia e saj në historinë e Pogradecit", përmenden rreth 23 figura të grave dhe të rejave të Pogradecit që kanë dhënë kontribute të jashtëzakonshme si mësuese, luftëtare, aktiviste, artiste, mjeke, ekonomiste, pedagoge, përkthyese, si dhe e vetmja grua në pozicionin e Kryetares së Bashkisë Pogradec.[5]

Nëse flasim për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Pogradec, kur i referohemi Këshillit Bashkiak, me një përbërje prej 31 anëtaresh e anëtarësh, nga të cilat 14 janë gra, vlen të

[1] Shih: https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter_2022_EN.pdf
[2] Shih: https://ccre-cemr.org/
[3] Shih: https://charter-equality.eu/atlas-of-signatories-of-the-charter/signataires.html?send=ok&c_id=1&nh_id=0&ct_id=0
[4] Shih: https://bashkiapogradec.gov.al/ngarkime/njoftimet/docs/280120221247-pvbgj-bashkia-pogradec-16-shtator-2020-.docx
[5] https://www.facebook.com/photo/?fbid=3253334301395073&set=pcb.3253335171394986

evidentohet se ky Këshill ka Kryetare një grua, ka bashkë Zëvendëskryetare një grua dhe Sekretare të Këshillit Bashkiak sërish një grua. "Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian" që ka në përbërje pesë anëtare e anëtarë nga të cilat dy gra, sërish drejtohet nga një grua. Po kështu, vihet re që gratë kanë një përfaqësim të mirë edhe në strukturat e Bashkisë, me një grua nënkryetare, një grua Drejtore Kabineti, dhe me drejtuese gra përkatësisht në: Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Qendrën Arsimore, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Njësinë e Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj, Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Drejtorinë e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtorinë e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës në Njësitë Administrative, si dhe në Sektorin e Auditit. Por, në nivelin e Njësive Administrative nuk ka asnjë Administratore grua dhe në nivelin e fshatrave nuk ka asnjë grua si Kryetare Fshati.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030, u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Këshillin Vendor Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak.

I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

**Barazia gjinore** nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lira/lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga steriotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

**Drejtësia gjinore** nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).[6]

Sikurse përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të përparojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve vendorë,

[6] Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: https://eige.europa.eu/thesaurus/browse

për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave[7], të rejave dhe të rinjve[8], vajzave dhe djemve.[9] Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore.

PVVBGJ 2025 - 2030 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentet kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore. Fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore për Bashkinë Pogradec.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PVVBGJ 2025 - 2030, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.

Pavarësisht ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme, me gjithë përpjekjet e bëra apo që vijojnë të bëhen ndër vite për përparimin drejt barazisë gjinore, si dhe plotësimin e harmonizimin e kuadrit ligjor dhe të politikave vendore me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e steriotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes vendore të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikat e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, pra të të gjitha/gjithë anëtareve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore.

---

[7] "Gra dhe burra" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

[8] "Të reja dhe të rinj" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 15 - 29 vjeç, në respektim edhe të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë"

[9] "Vajza dhe djem" në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç, në përputhje me Ligjin Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" (neni 3, pika 4).

Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithëpërfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja ***"në të gjithë diversitetin e tyre"***, që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, *të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuara, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj.,* pra nga të gjithë grupet në shoqëri. Ky term gjithashtu përdoret gjerësisht në dokumentet e Bashkimit Evropian, sidomos ato që janë pjesë e acquis të BE-së për barazinë gjinore, ku specifikisht adresojmë Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020 – 2025, si dhe Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III 2021 – 2025/2027[10] (EU GAP III).

Theksi te gratë, të rejat dhe vajzat, ***nga të gjitha gupet në shoqëri,*** është vënë edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, dokumenti kryesor i politikave në nivel kombëtar që përshkruan veprimet që duhet të ndërmerren për përparimin drejt barazisë gjinore.

***Prandaj, kudo në këtë tekst, togfjalëshi "në të gjithë diversitetin e tyre" nënkupton që veprimet dhe masat e ndërmarra synojnë të përfshijnë gra, të reja, vajza në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuara, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj.***

## II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Në nenin 18 të Kushtetutës qartësohet shprehimisht se: "*1. Të gjitha/gjithë janë të barabarta/barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive*".

Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentesh ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohemi parashikimeve në instrumentet ndërkombëtarë të ratifikuar.

[10] EU GAP III u përgatit fillimisht për periudhën kohore 2021 – 2025, por në nëntor të vitit 2023, BE vendosi të shtrijë kohëzgjatjen e tij deri ne vitin 2027. Shih: https://enlargement.ec.europa.eu/news/gender-equality-eu-extends-duration-gender-action-plan-external-action-build-its-achievements-2023-11-21_en

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

*a) Instrumente ndërkombëtarë*

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore (EU Charter for Equality).[11]
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjenda 2030.
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2021-2025/2027.
- Udhërrëfyesi i BE-së për fuqizimin e grave, publikuar në 7 mars 2025[12], etj.

*b) Kuadri ligjor kombëtar*[13]

- Ligji Nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (në proces rishikimi).
- Ligji Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- Ligji Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.
- Ligji Nr.221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.
- Ligji Nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".
- Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

[11] E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndonëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.

[12] Shih: https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2025/769542/EPRS_BRI(2025)769542_EN.pdf

[13] Theksojmë se kjo listë nuk është shteruese. Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ, mbështeten jo vetëm në këtë kuadër ligjor për barazinë gjinore, por edhe në ligje të veçanta në përputhje me fushën përkatëse të ndërhyrjes.

- Ligji Nr. 37/2017 "Kodi i drejtësisë penale për të mitur".
- Ligji Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i procedurës penale", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin".
- Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit".
- Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë", i ndryshuar etj.

c) ***Politikat kombëtare***

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2025 - 2030 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030.**[14]

d) ***Institucionet përgjegjëse***

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjëse/përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. ***Megjithatë, ky Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, nuk është plani i një nëpunëseje/nëpunësi të vetëm, por është një dokument i Bashkisë***, për zbatimin me efektivitet të të cilit mban përgjegjësi i gjithë stafi i bashkisë dhe njësive administrative, në bashkëpunim dhe me të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në këtë drejtim.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe ***Aleanca e Grave Këshilltare*** dhe ***Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian***[15] në nivel të Këshillit Bashkiak.

Për të pasur efektivitet në zbatimin e PVVBGJ dhe monitorimin e vazhdueshëm të këtij zbatimi, Bashkia Pogradec ka planifikuar si pjesë të veprimeve të këtij PVVBGJ edhe ngritjen e një *Komisioni për Barazi Gjinore / Grupi Monitorimi* në nivel bashkie, i përbërë nga përfaqësuese e përfaqësues të Drejtorive përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, duke përfshirë jo vetëm ato/ata të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan, por edhe të drejtorive të tjera sipas nevojës.

---

[14] Miratuar me VKM nr.400, datë 30.06.2021. Shiko: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx

[15] Shih: https://bashkiapogradec.gov.al/faqe/komisionet-e-keshillit-42/

Ky Komision/Grup, do të mundësojë një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së edhe për ata elementë që nuk janë të përmendur në mënyrë të detajuar në matricë, por që siç u theksua edhe më sipër, janë të domosdoshëm për përparimin në drejtim të fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre dhe arritjen e barazisë gjinore (p.sh. ky Komision/Grup do të mundësojë përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjithë dokumentet zhvillimorë të bashkisë, pavarësisht sektorit apo çështjes që mbulojnë). Ndaj dhe formalizimi i këtij Komisioni për Barazinë Gjinore/ Grupi Monitorues për PVVBGJ në nivel bashkie është një ndër hapat e parë të parashikuar për zbatim, menjëherë pas miratimit të PVVBGJ në Këshillin Bashkiak.

Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PVVBGJ.

## III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2025 - 2030 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Ngritja e Grupit të Punës.** Grupi i Punës për hartimin e këtij PVVBGJ u ngrit me Urdhër të Kryetarit, nr. 18, datë 27.01.2025 "Për krijimin e grupit të punës për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ)". Në përbërje të këtij grupi ishin 9 anëtare/anëtarë, nga të cilat/cilët 8 gra dhe 1 burrë.

- ***Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review).*** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.

- ***Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2025-2030.*** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioriteteve bazuar në desk review, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë.

- ***Konsultimet paraprake brenda bashkisë.*** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratorët e NJA-ve. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundësuar njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët, por edhe për të

diskutuar mbi detaje që lidhen me formatin dhe përmbajtjen në tërësi të PVVBGJ. Janë zhvilluar gjithsej ***katër takime të Grupit të Punës***, përkatësisht në datat 5 shkurt 2025, 25 mars 2025, 10 prill 2025 dhe 28 prill 2025.

- **Konsultim me një grup të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh**. Grupi i Punës mendoi që në takimin e tretë të tij (përkatësisht në datën 10 prill 2025) të ftonte edhe një rreth të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh, për të diskutuar parimisht mbi përmbajtjen e PVVBGJ. Ky takim rezultoi shumë i suksesshëm, me praninë e rreth 30 pjesëmarrëseve/pjesëmarrësve, si dhe me shumë diskutime e propozime konkrete nga të ftuarat/ftuarit. Po kështu, një takim konsultues i dedikua u realizua edhe me të rejat dhe të rinjtë, përfaqësuese e përfaqësues të Këshillit Vendor Rinor, në datën 3 prill 2025.

- ***Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 - 2030.*** Drafti matrica e përgatitur për konsultimet paraprake e partnerët, bashkëpunëtorët dhe rininë, përmbante masat dhe veprimet e parashikuara të përfshira në pesë fusha ndërhyrjeje, ku katër të parat bazoheshin në fushat prioritare të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 (pra fuqizimi ekonomik, pjesëmarrja në vendimmarrjen politike e publike, dhuna me bazë gjinore dhe integrimi gjinor ne nivelin vendor), si dhe një fushë e pestë me masa të ndryshme të propozuara, të cilat pas konsultimeve paraprake, u saktësuan në cilat prej objektivave strategjike e specifike të PVVBGJ do të përfshiheshin. Të gjitha ndryshimet pas konsultimeve paraprake janë dakordësuar me grupin e punës.

- ***Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.*** Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, OJF-të bashkëpunëtore, si dhe anëtare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit Bashkiak. Sipas kërkesave dhe legjislacionit në fuqi, draft PVVBGJ u postua në faqen e internetit të bashkisë për konsultim publik.[16]

- ***Kostimi i draft PVVBGJ 2025-2030.*** Pas finalizimit të matricës së aktiviteteve dhe qartësimit të tyre me çdo drejtori, paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakortësuara.

- ***Miratimi i PVVBGJ 2025 – 2030 në Këshillin Bashkiak.*** Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ 2025 – 2030 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë, si dhe versioni anglisht i tij do të publikohet në faqen e Atlasit të Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes së PVVBGJ-ve siç sugjerohet nga KBRE.[17]

[16] Shih: https://bashkiapogradec.gov.al/publikime-kategori/njoftime-te-keshillit-bashkiak-12/
[17] Për më shumë shih: https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PVVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Women, përmes dy konsulenteve[18] të angazhuara për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të projektit: Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

## IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

**Vizioni:** *"Gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Pogradecit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës".*

**Parimet**[19] që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, në vendimmarrje, është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i steriotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

**Fushat kryesore të ndërhyrjes**

PVVBGJ 2025 - 2030 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifikë të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.

[18] Znj. Monika Kocaqi, eksperte e nivelit të lartë për integrimin gjinor dhe vetëqeverisjen vendore, si dhe znj. Diamanta Vito, eksperte e nivelit të lartë për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe vetëqeverisjen vendore. Për përgatitjen e treguesve gjinorë të këtij PVVBGJ u angazhua edhe znj. Majlinda Nesturi, eksperte e nivelit të lartë për statistikat dhe treguesit gjinorë.

[19] Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.
III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

**Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit**

**Fusha e ndërhyrjes:**

**I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.**

**Rezultatet e pritshme:**

I.a. Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.

I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.

**Objektivat specifikë:**

I.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.

**Treguesit në nivel objektivi specifik:**

I.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit), etj.

I.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të rejat, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit

Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).

**Fusha e ndërhyrjes:**

**II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.**

**Rezultatet e pritshme:**

II.a. Aktivitetet dedikuar pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendimmarrjen politike apo publike, adresojnë në mënyrën e duhur sfidat dhe steriotipet gjinore ekzistuese.

II. b. Veprimet që ndërmerr bashkia në këtë drejtim, nxitin zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe parimet e barazisë e gjithëpërfshirjes, veçanërisht për grupet më pak të përfaqësuara.

**Objektivat specifikë:**

II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin e tyre.

**Treguesit në nivel objektivi specifik:**

II.1.a. Numri i të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë përfunduar trajnime për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe për integrimin gjinor në vendimmarrje.

II.1.b. Përqindja e grave dhe të rejave drejtuese, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkiak, Njësitë Administrative, Këshillat e Fshatrave, etj.

**Fusha e ndërhyrjes:**

**III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.**

**Rezultatet e pritshme:**

III.a. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe efikas.

III.b. Një brez i ri i barazisë, që lufton steriotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar.

III.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm.

**Objektivat specifikë:**

III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.

III.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore dhe promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".

**Treguesit në nivel objektivi specifik:**

III.1.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuara dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia.

III.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

III.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

III.2.b. Përqindja e grave, burrave, të rejave dhe të rinjve të përfshira/përfshirë në aktivitete që synojnë paqen, sigurinë dhe ndërtimin e komuniteteve të sigurta e gjithëpërfshirëse.

**Fusha e ndërhyrjes:**

**IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.**

**Rezultatet e pritshme:**

IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.

I.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integrimi gjinor i reflektuar në politikat dhe planet e bashkisë.

**Objektivat specifikë:**

IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.

IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.

**Treguesit në nivel objektivi specifik:**

IV.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë dhe në Atlasin e Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).

IV.2.a. Numri i programeve buxhetore të analizuara nën këndvështrimin gjinor.

IV.2.b. Përqindja e buxhetit vjetor të bashkisë e dedikuar për zbatimin e PVVBGJ, dhe norma vjetore e rritjes së tij, krahasuar me përqindjen e buxhetit të shpenzuar për këtë qëllim.

## V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025 - 2030

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PVVBGJ 2025 - 2030 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj. – ***pra që nuk ka nevojë për kosto shtesë pasi këto kosto parashikohen në mënyrë të përvitshme.*** Megjithatë, në këtë Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2025 - 2030 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij

kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Në seksionin VI "Matrica e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030", për çdo masë/aktivitet të parashikuar, në kolonën e kostos jepet informacion për:

a. **Vlerën totale të kostos të zhvillimit të masës/aktivitetit.** Kjo kosto është përllogaritur si kosto bazë (pra me zërat që përmban zbatimi i aktivitetit), e shumëzuar me numrin e aktiviteteve të parashikuara për zbatim për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të PVVBGJ.
b. **Vlerën e kostos që mbulohet nga Bashkia.** Këtu duhet pasur parasysh se kjo vlerë jo domosdoshmërisht është shtesë në buxhetin e bashkisë, ajo mund të jetë edhe në formën e angazhimit të pjesshëm të specialisteve/specialistëve të drejtorive përkatëse (pra disa ditë pune ia kushtojnë zbatimit të masës/aktivitetit, brenda pagës mujore që kanë), ose në formën e kontributit "në natyrë (in kind)" përmes vënies në dispozicion të sallave e ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përllogaritjet financiare.
c. **Vlerën e kostos që mbulohet nga donatorët.** Kjo nënkupton që për zhvillimin e masës/aktivitetit ka një dakortësi paraprake me donatorët mbi kontributin e tyre. Në këtë rast, janë përllogaritur si të mbuluara, vetëm kostot për ato aktivitete që ka pasur një dakortësi / marrëveshje mes bashkisë dhe donatorit, në momentin e përgatitjes së këtij PVVBGJ. Paralelisht, bashkia do vijojë punën për identifikimin e donatorëve të ndryshëm dhe shtimin e mbështetjes nga ana e tyre, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij PVVBGJ.
d. **Hendeku financiar.** Ky ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negocimit me donatorët, bizneset, OJF të specializuara, etj., ose mund edhe të parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2026-2028.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Plani Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë, Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve / masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, ***duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara***, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore,

për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2025 - 2030 janë në vlerën **14,938,905 lekë**. Nga këto:

- ***5,085,859 lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I "Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre".
- ***1,064,496 lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II "Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor".
- ***6,739,248 lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes III "Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje".
- **2,049,302** ***lekë*** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV "Integrimi gjinor në politikat vendore".

Në totalin e kostos **14,938,905 lekë** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PVVBGJ 2025-2030 për të gjithë kohëzgjatjen e tij:

- ***8,124,981 lekë janë kosto që do të mbulohen nga Bashkia*** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra ***të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukturore ekzistojnë.***
- ***5,034,633 lekë janë kosto që mbulohen nga donatorë*** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PVVBGJ-së).
- ***1,798,791 lekë janë hendek financiar,*** për të cilat bashkia do të lobojë për gjetjen e burimeve financuese, ose do të bëjë planifikimet e saj shtesë në PBA-të e ardhshme.

| **Objektivat strategjikë** | **Objektivat specifikë** | **Gjithsej kosto 2025 - 2030** | **Bashkia (Lekë)** | **Donatorë të konfirmuar (Lekë)** | **Hendek financiar (Lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|
| **I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.** | I.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre. | 5,085,859 lekë | 1,514,316 lekë | 3,334,333 lekë | 237,210 lekë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej Objektivi strategjik I:** | | **5,085,859 lekë** | **1,514,316 lekë** | **3,334,333 lekë** | **237,210 lekë** |
| **II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.** | II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin e tyre. | 1,064,496 lekë | 269,830 lekë | 731,500 lekë | 63,166 lekë |
| **Gjithsej Objektivi strategjik II:** | | **1,064,496 lekë** | **269,830 lekë** | **731,500 lekë** | **63,166 lekë** |
| **III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.** | III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje. | 3,833,568 lekë | 3,399,768 lekë | 139,800 lekë | 294,000 lekë |
| | III.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore dhe promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria". | 2,905,680 lekë | 1,827,165 lekë | 424,000 lekë | 674,015 lekë |
| **Gjithsej Objektivi strategjik III:** | | **6,739,248 lekë** | **5,226,933 lekë** | **563,800 lekë** | **968,015 lekë** |
| **4. Integrimi gjinor në** | IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe | 1,084,094 lekë | 694,094 lekë | 360,000 lekë | 30,000 lekë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **politikat vendore.** | transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore. | | | | |
| | IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor. | 965,208 lekë | 419,808 lekë | 45,000 lekë | 500,400 lekë |
| **Gjithsej Objektivi strategjik IV:** | | **2,049,302 lekë** | **1,113,902 lekë** | **405,000 lekë** | **530,400 lekë** |

## VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

***Procesi i raportimit*** për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria ose Sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek ***Komisioni për Barazinë Gjinore / Grupi i Monitorimit për zbatimin e PVVBGJ, që do të ngrihet menjëherë pas miratimit të këtij PVVBGJ në nivel të Bashkisë, me përfaqësuese dhe përfaqësues nga secila drejtori në bashki.***

Menjëherë pas miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030, si hap i parë i zbatimit të tij, do të hartohen gjithashtu edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifikë.

***Raportimet mbi aktivitetet*** **do të jenë** ***periodike (çdo 3 muaj)*** ose në bazë të kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore / Grupit të Monitorimit në nivel bashkie, apo Kabinetit të Kryetares/Kryetarit.

***Raportimet në bazë të objektivave specifikë*** do të përgatiten ***dy herë në vit (çdo 6 muaj).***

***Monitorimi*** i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit ***në nivel të objektivave*** do të kryhet nga ***Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak. Bashkia ka përgjegjësinë të përgatisë dhe paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak një raport monitorimi çdo vit.***

Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Aleanca e Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), te Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor apo edhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

Bazuar në monitorimin e kryer, PVVBGJ ***duhet të rishikohet dhe përmirësohet*** në mënyrë periodike, sipas nevojës, qoftë edhe çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

## VII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030

| Fusha e ndërhyrjes (Objektivi strategjik): | I. PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE. |
|---|---|
| **Rezultatet e pritshme:** | I.a. Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.<br>I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike. |
| **Dokumentet kryesore që u referohemi:** | - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 11, 17, 27.<br>- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 11, 12, 13.<br>- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 6.<br>- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – neni 12/6.<br>- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla III, fushat kryesore tematike 3.3, 3.6.<br>- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – objektivat specifikë I.1, I.2, I.3. |
| **Objektivi specifik:** | **I.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.** |

| Treguesit: | Baseline: (2025) | Target: (2030) | MONITORIMI |
|---|---|---|---|
| I.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit), etj. | Do përcaktohet | Rritur me 10% (2% çdo vit) | Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ;<br>Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak. |
| I.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të rejat, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.). | Do përcaktohet | Rritur me 2.5% (0.5% çdo vit) | |

| MASAT DHE AKTIVITETET | ZBATIMI | AFATI KOHOR | TREGUES | KOSTO (LEKË) |
|---|---|---|---|---|

| | Përgjegjës kryesor | Mbështetës | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I.1.1. Trajnime për zhvillimin e aftësive profesionale për gratë, të rejat dhe vajzat në sektorë të ndryshëm, përfshirë edhe në fushën e teknologjisë dhe menaxhimit të biznesit. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Qendra Arsimore, Zyra Vendore e Punësimit, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2026 – 2030 | 2 trajnime në vit<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | *N/a* | 26,000 lekë<br><br>(nga të cilat 6,000 lekë bashkia dhe 20,000 lekë donatorë) | 26,000 lekë<br><br>(nga të cilat 6,000 lekë bashkia dhe 20,000 lekë donatorë) | 26,000 lekë<br><br>(nga të cilat 6,000 lekë bashkia dhe 20,000 lekë donatorë) | 26,000 lekë<br><br>(nga të cilat 6,000 lekë bashkia dhe 20,000 lekë donatorë) | 26,000 lekë<br><br>(nga të cilat 6,000 lekë bashkia dhe 20,000 lekë donatorë) |
| I.1.2. Informimi i rregullt i grave/të rejave dhe burrave/të rinjve mbi mbështetjen që ofrohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe mënyrën e përfitimit të kësaj mbështetjeje. | Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative | AZHBR, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Zyra Vendore e Punësimit, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 1 sesion në vit<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | 59,396 lekë<br><br>(bashkia) | 59,396 lekë<br><br>(bashkia) | 59,396 lekë<br><br>(bashkia) | 59,396 lekë<br><br>(bashkia) | 59,396 lekë<br><br>(bashkia) | 59,396 lekë<br><br>(bashkia) |
| I.1.3. Zhvillimi i aftësive profesionale për gratë dhe të rejat në fshatra, përmes trajnimeve dhe sesioneve mbështetëse fokusuar kryesisht te bujqësia, turizmi dhe zhvillimi rural. | Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në | AZHBR, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Zyra Vendore e Punësimit, OJF, | 2026 – 2030 | 2 trajnime në vit<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas | N/a | 18,792 lekë<br><br>(bashkia) | 18,792 lekë<br><br>(bashkia) | 18,792 lekë<br><br>(bashkia) | 18,792 lekë<br><br>(bashkia) | 18,792 lekë<br><br>(bashkia) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Njësitë Administrative | organizatat ndërkombëtare | | seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | | | | | | |
| I.1.4. Vazhdimi i mbështetjes së grave artizane me mbajtjen hapur dhe pa tarifa vendore, të dyqanit të shitjes së produkteve të tyre (ngritur nga Bashkia) | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Zyra Vendore e Punësimit, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 – 2030 | Gratë artizane të mbështetura me dyqanin për shitjen e produkteve, pa tarifa | Kosto e përfshirë në buxhetin ekzistues | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) |
| I.1.5 Lehtësimi fiskal dhe promovimi i modeleve të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, në biznes | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | AKPA, Zyra Vendore e Punësimit, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2026 – 2030 | Promovime nëpërmjet mediave sociale | *N/a* | 80,000 lekë (bashkia) | 80,000 lekë (bashkia) | 80,000 lekë (bashkia) | 80,000 lekë (bashkia) | 80,000 lekë (bashkia) |
| I.1.6. Takime dhe informim për inkurajimin e pjesëmarrjes së të rejave dhe të rinjve, veçanërisht nga zonat e thella rurale, në aktivitete dhe kurse që zhvillojnë aftësi profesionale dhe teknike. | Qendra Arsimore | Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Zyra Vendore e Punësimit, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 2 takime në vit<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | *53,250 lekë (nga të cilat 12,250 lekë bashkia dhe 41,000 lekë hendek financiar)* | 53,250 lekë (nga të cilat 12,250 lekë bashkia dhe 41,000 lekë hendek financiar) | 53,250 lekë (nga të cilat 12,250 lekë bashkia dhe 41,000 lekë hendek financiar) | 53,250 lekë (nga të cilat 12,250 lekë bashkia dhe 41,000 lekë hendek financiar) | 53,250 lekë (nga të cilat 12,250 lekë bashkia dhe 41,000 lekë hendek financiar) | 53,250 lekë (nga të cilat 12,250 lekë bashkia dhe 41,000 lekë hendek financiar) |
| I.1.7. Takime informuese dhe udhëzime për mbështetjen që ofrohet | Qendra Arsimore | Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Zyra | 2025 – 2030 | 2 takime në vit | 546,760 lekë | 546,760 lekë | 546,760 lekë | 546,760 lekë | 546,760 lekë | 546,760 lekë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| nga Zyra e Punës nëpërmjet programeve të vetëpunësimit (mbështetja deri në 500,000 lekë për hapjen e një biznesi), si dhe mënyrën e aplikimit. | | Vendore e Punësimit, OJF, organizatat ndërkombëtare | | Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | (nga të cilat46,760 lekë bashkia dhe 500,000 lekë donatorë) | (nga të cilat46,760 lekë bashkia dhe 500,000 lekë donatorë) | (nga të cilat46,760 lekë bashkia dhe 500,000 lekë donatorë) | (nga të cilat46,760 lekë bashkia dhe 500,000 lekë donatorë) | (nga të cilat46,760 lekë bashkia dhe 500,000 lekë donatorë) | (nga të cilat46,760 lekë bashkia dhe 500,000 lekë donatorë) |
| I.1.8. Përfshirja e tematikës së thyerjes së steriotipeve gjinore në punësim, në sesionet e këshillimit dhe karrierës. | Qendra Arsimore | Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Zyra Vendore e Punësimit, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 3 sesione në vit<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | 35,583 lekë<br><br>(donatorë) | 35,583 lekë<br><br>(donatorë) | 35,583 lekë<br><br>(donatorë) | 35,583 lekë<br><br>(donatorë) | 35,583 lekë<br><br>(donatorë) | 35,583 lekë<br><br>(donatorë) |
| I.1.9. Takim me Inspektoriatin e Punës me fokus shtimin e kontrolleve për të mundësuar sigurimin e kushteve të përshtatshme, të drejta dhe të barabarta në vendin e punës, në përputhje me nevojat për secilën gjini. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Sektori i Inspektimit, Korçë | 2026 | 1 takim | *N/a* | 28,188 lekë<br><br>(nga të cilat 24,105 lekë bashkia dhe 4,083 lekë donatorë) | N/a | N/a | N/a | N/a |
| I.1.10. Shtimi i shërbimeve të përkujdesit për fëmijët | Qendra Arsimore | MAS | 2026 – | 1 çerdhe | *N/a* | Kosto do përllogarite | N/a | N/a | N/a | N/a |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| vajza dhe djem (çerdhe në qytet) si një mundësi për më shumë hapësirë për punësimin e nënave. | | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | 2030 | | | t në bazë të studimit të fizibilitetit | | | | |
| I.1.11. Trajnimi trajnerësh për punonjëset/ punonjësit e Bashkisë mbi Konventën C190 të ONP-së mbi dhunën dhe ngacmimet seksuale në vendin e punës. | Drejtoria e Burimeve Njerëzore | ASPA, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, OJF, organizata ndërkombëtare | 2026 | 1 trajnim<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | *N/a* | 13,000 lekë<br><br>(nga të cilat 3,000 lekë bashkia dhe 10,000 lekë hendek financiar) | N/a | N/a | N/a | N/a |
| I.1.12. Plotësimi i Kodit Etik/hartimi i një politike (së bashku me mekanizmin e përcjelljes së ankesave) kundër dhunës dhe ngacmimit seksual në vendin e punës. | Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve | Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, OJF, organizata ndërkombëtare ... | 2027 | Kodi i rishikuar / politika e hartuar | *N/a* | N/a | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | N/a | N/a | N/a |
| I.1.13. Informim i komunitetit në tërësi, veçanërisht grave dhe vajzave, mbi të drejtat pronësore, përfshirë pronësinë mbi tokën bujqësore. | Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative | Drejtoria e Shërbimeve Sociale, OJF, organizata ndërkombëtare | 2026 – 2030 | 1 takim në vit<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, | *N/a* | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | etnisë,<br>aftësive, etj. | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **Fusha e ndërhyrjes (Objektivi strategjik):** | **II. RRITJA E PJESËMARRJES DHE PËRFAQËSIMIT TË GRAVE DHE TË REJAVE E TË RINJVE, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE, NË VENDIMMARRJEN POLITIKE APO PUBLIKE NË NIVELIN VENDOR.** |
| **Rezultatet e pritshme:** | II.a. Aktivitetet dedikuar pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendimmarrjen politike apo publike, adresojnë në mënyrën e duhur sfidat dhe steriotipet gjinore ekzistuese.<br>II. b. Veprimet që ndërmerr bashkia në këtë drejtim, nxitin zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe parimet e barazisë e gjithëpërfshirjes, veçanërisht për grupet më pak të përfaqësuara. |
| **Dokumentet kryesore që u referohemi:** | - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 2 dhe 3.<br>- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – dhe nenet 7 dhe 8.<br>- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 7.<br>- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – neni 4/3.<br>- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla 1 dhe 5, fushat kryesore tematike 3.3, 3.6.<br>- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – fusha e ndërhyrjes II, objektivi specifik II.1. |
| **Objektivi specifik:** | **II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të rejat, në të gjithë diversitetin e tyre.** |

| **Treguesit:** | **Baseline: (2025)** | **Target: (2030)** | **MONITORIMI** |
|---|---|---|---|
| II.1.a. Numri i të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë përfunduar trajnime për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe për integrimin gjinor në vendimmarrje. | Do përcaktohet | Rritur me 10% (2% çdo vit) | Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak. |
| II.1.b. Përqindja e grave dhe të rejave drejtuese, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkiak, Njësitë Administrative, Këshillat e Fshatrave, etj. | Do përcaktohet | Rritur në përputhje me legjislacionin në fuqi | |

| MASAT DHE AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | TREGUES | KOSTO (LEKË) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përgjegjës kryesor | Mbështetës | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
| II.1.1. Takime motivuese me gra dhe të reja në pozicione vendimmarrëse. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Aleanca e Grave Këshilltare, Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore (etj.), OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 1 takim në vit<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | 7,166 lekë<br><br>(bashkia) | 7,166 lekë<br><br>(bashkia) | 7,166 lekë<br><br>(bashkia) | 7,166 lekë<br><br>(bashkia) | 7,166 lekë<br><br>(bashkia) | 7,166 lekë<br><br>(bashkia) |
| II.1.2. Trajnim mbi barazinë gjinore dhe lidershipin me AGK dhe Komisionin e Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 1 trajnim<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | 54,500 lekë<br><br>(nga të cilat 6,500 lekë bashkia, 20,000 lekë donatorë dhe 28,000 lekë hendek financiar) | 54,500 lekë<br><br>(nga të cilat 6,500 lekë bashkia, 20,000 lekë donatorë dhe 28,000 lekë hendek financiar) | 54,500 lekë<br><br>(nga të cilat 6,500 lekë bashkia, 48,000 lekë donatorë) | 54,500 lekë<br><br>(nga të cilat 6,500 lekë bashkia, 48,000 lekë donatorë) | 54,500 lekë<br><br>(nga të cilat 6,500 lekë bashkia, 48,000 lekë donatorë) | 54,500 lekë<br><br>(nga të cilat 6,500 lekë bashkia, 48,000 lekë donatorë) |
| II.1.3. Trajnime të të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, për formimin e aftësive | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 - 2030 | 2 trajnime në vit<br><br>Numri i personave të | 79,500 lekë<br><br>(nga të cilat 11,500 lekë bashkia dhe | 79,500 lekë<br><br>(nga të cilat 11,500 lekë | 79,500 lekë<br><br>(nga të cilat 11,500 lekë | 79,500 lekë<br><br>(nga të cilat 11,500 lekë | 79,500 lekë<br><br>(nga të cilat 11,500 lekë | 79,500 lekë<br><br>(nga të cilat 11,500 lekë bashkia |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| udhëheqëse dhe drejtuese. | | | | përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | 68,000 lekë donatorë) | bashkia dhe 68,000 lekë donatorë) | bashkia dhe 68,000 lekë donatorë) | bashkia dhe 68,000 lekë donatorë) | bashkia dhe 68,000 lekë donatorë) | dhe 68,000 lekë donatorë) |
| II.1.4. Përfshirja e vazhdueshme e të rejave dhe të rinjve në proceset vendimmarrëse të politikave rinore, sociale, të barazisë gjinore, fuqizimit ekonomik, zhvillimit urban e mjedisor dhe në çdo politikë tjetër të rëndësishme që harton bashkia | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Të gjitha drejtoritë në bashki që hartojnë politika dhe plane zhvillimi | 2025 – 2030 | Të paktën një takim për çdo politikë dhe plan që hartohet në bashki.<br><br>Numri i personave të përfshirë ndarë sipas seksit, moshës, vendbanimit, etnisë, aftësive, etj. | 22,000 lekë<br><br>(nga të cilat 12,000 lekë bashkia dhe 10,000 lekë donatorë) | 22,000 lekë<br><br>(nga të cilat 12,000 lekë bashkia dhe 10,000 lekë donatorë) | 22,000 lekë<br><br>(nga të cilat 12,000 lekë bashkia dhe 10,000 lekë donatorë) | 22,000 lekë<br><br>(nga të cilat 12,000 lekë bashkia dhe 10,000 lekë donatorë) | 22,000 lekë<br><br>(nga të cilat 12,000 lekë bashkia dhe 10,000 lekë donatorë) | 22,000 lekë<br><br>(nga të cilat 12,000 lekë bashkia dhe 10,000 lekë donatorë) |
| II.1.5. Inkurajimi i të rejave dhe grave për t'u përfshirë dhe kandiduar në pozicionin e Kryetares së Fshatit. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Njësitë Administrative, OJF, organizata ndërkombëtare... | 2026 – 2027 | 7 takime gjithsej | *N/a* | 15,750 lekë<br><br>(donatorë) | 15,750 lekë<br><br>(donatorë) | N/a | N/a | N/a |
| II.1.6. Zbatimi i parimeve të barazisë gjinore në emërimet që bën bashkia në pozicionet drejtuese | Kabineti i Kryetarit | Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe | 2025 - 2030 | Emërimet e bëra marrin në konsideratë | 9,000 lekë<br><br>(bashkia) | 9,000 lekë<br><br>(bashkia) | 9,000 lekë<br><br>(bashkia) | 9,000 lekë<br><br>(bashkia) | 9,000 lekë<br><br>(bashkia) | 9,000 lekë<br><br>(bashkia) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| (veçanërisht Administratore/Administratorë në NJA). | | Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Aleanca e Grave Këshilltare | | parimet e BGJ | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **Fusha e ndërhyrjes (Objektivi strategjik):** | **III. LIRI NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE.** |
| **Rezultatet e pritshme:** | III.a. Mekanizmi i Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe efikas.<br>III.b. Një brez i ri i barazisë, që lufton steriotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar.<br>III.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm. |
| **Dokumentet kryesore që u referohemi:** | - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality) – nenet 6, 10, 13, 16, 20, 21, 22, 23.<br>- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – nenet 2, 5, 6, 10, 16.<br>- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) – fusha kritike 2, 9.<br>- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 1/b, 4/2, 4/3, 12/1, 7, 8, 11, 12/6, 13, 14, 16, 17, 19, 22, 23, 50, 51, 52, 53, etj.<br>- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – objektivi specifik tematik 2, shtylla III, fusha kryesore tematike 3.1, 3.5.<br>_Agjenda "Gruaja, Paqja, Siguria" dhe Agjenda "Rinia, Paqja, Siguria".<br>- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – fusha e ndërhyrjes III, objektivi specifik III.2.III.4. |
| **Objektivi specifik:** | **III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.** |

| **Treguesit:** | **Baseline: (2025)** | **Target: (2030)** | **MONITORIMI** |
|---|---|---|---|
| III.1.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuara dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia. | Do përcaktohet | Rritur me 5% (1% çdo vit) | Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| III.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. | Do përcaktohet | Rritur me 5% (1% çdo vit) | Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak. |

| MASAT DHE AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | TREGUES | KOSTO (LEKË) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përgjegjës kryesor | Mbështetës | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
| III.1.1. Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Komitetit Drejtues të MKR | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 – 2030 | Të paktën një herë në vit | 14,488 lekë (bashkia) | 14,488 lekë (bashkia) | 14,488 lekë (bashkia) | 14,488 lekë (bashkia) | 14,488 lekë (bashkia) | 14,488 lekë (bashkia) |
| III.1.2. Organizimi i mbledhjeve të rregullta të ETN, mbledhje periodike dhe në varësi të rasteve | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëtare... | 2025 – 2030 | Çdo 3 muaj | 29,488 lekë (bashkia) | 29,488 lekë (bashkia) | 29,488 lekë (bashkia) | 29,488 lekë (bashkia) | 29,488 lekë (bashkia) | 29,488 lekë (bashkia) |
| III.1.3. Vazhdimi i menaxhimit të rasteve me përparësi dhe efektivitet përmes koordinimit me ETN | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata | 2025 - 2030 | Numri i rasteve të menaxhuara çdo vit. | 73,200 lekë (bashkia) | 92,400 lekë (bashkia) | 92,400 lekë (bashkia) | 92,400 lekë (bashkia) | 92,400 lekë (bashkia) | 92,400 lekë (bashkia) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndërkombëta re | | Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | | | | | | |
| III.1.4. Mbajtja e raporteve dhe dokumentacioneve të rregullta dhe dorëzimi i tyre (sipas kërkesës) në Gjykatë. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec | 2025 - 2030 | Numri i raporteve dhe dokumentev e të mbajtura dhe dorëzuara nga Bashkia, sipas kërkesës në Gjykatë, për çdo rast të trajtuar | 133,128 lekë (bashkia) | 133,128 lekë (bashkia) | 133,128 lekë (bashkia) | 133,128 lekë (bashkia) | 133,128 lekë (bashkia) | 133,128 lekë (bashkia) |
| III.1.5. Prezenca e KV dhe PMF sipas kërkesës e detyrimit ligjor në Gjykatë | KV dhe PMF | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | 2025 - 2030 | Numri i seancave ku KV dhe PMF janë prezent në gjykatë sipas rastit, çdo muaj | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) | 48,000 lekë (bashkia) |
| III.1.6. Vazhdimi i monitorimit të rregullt të zbatimit të UM | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec | 2025 - 2030 | Numri i raporteve të monitorimit të përgatitura dhe | 17,424 lekë (bashkia) | 17,424 lekë (bashkia) | 17,424 lekë (bashkia) | 17,424 lekë (bashkia) | 17,424 lekë (bashkia) | 17,424 lekë (bashkia) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dorëzuara në polici, për çdo rast të monitoruar | | | | | | |
| III.1.7. Përditësimi i databazës rregullisht (REVALB) dhe ndarja e të dhënave me anëtarët e MKR sipas kërkesës | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec | 2025 - 2030 | Data baza e përditësuar rregullisht | 62,064 lekë (bashkia) | 62,064 lekë (bashkia) | 62,064 lekë (bashkia) | 62,064 lekë (bashkia) | 62,064 lekë (bashkia) | 62,064 lekë (bashkia) |
| III.1.8. Takime individuale me mentorim për fuqizimin e kapaciteteve të anëtarëve të MKR (veçanërisht anëtarët e rinj dhe specifikisht komunitetet fetare) | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 – 2030 | Përgjatë vitit sipas nevojës.<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 67,236 lekë (bashkia) | 79,560 lekë (bashkia) | 79,560 lekë (bashkia) | 79,560 lekë (bashkia) | 79,560 lekë (bashkia) | 79,560 lekë (bashkia) |
| III.1.9. Përmirësimi i standardeve dhe kushteve të strehëzës së emergjencës dhe vazhdimi i ofrimit të shërbimit të strehimit emergjent. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëtare | 2027 – 2030 | Kushtet dhe standartet e përmirësuara | N/a | N/a | 90,000 lekë<br><br>(nga të cilat 30,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë hendek financiar) | 132,660 lekë<br><br>(nga të cilat 54,660 lekë bashkia dhe 78,000 lekë hendek financiar) | 132,660 lekë<br><br>(nga të cilat 54,660 lekë bashkia dhe 78,000 lekë hendek financiar) | 132,660 lekë<br><br>(nga të cilat 54,660 lekë bashkia dhe 78,000 lekë hendek financiar) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| III.1.10. Ofrimi i shërbimeve të vazhdueshme të këshillimit psikologjik dhe ligjor, për të gjitha rastet që ndiqen nga MKR. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 - 2030 | Numri i rasteve të mbuluara me shërbim të këshillimit psikologjik dhe ligjor, çdo muaj | 23,300 lekë (donatorë) | 23,300 lekë (donatorë) | 23,300 lekë (donatorë) | 23,300 lekë (donatorë) | 23,300 lekë (donatorë) | 23,300 lekë (donatorë) |
| III.1.11. Takim koordinues me shërbimet ekzistuese të këshillimit të djemve dhe burrave, si dhe këshillimit të dhunuesve për të parë mundësitë e ofrimit të këtij shërbimi edhe në Pogradec. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëtare... | 2025 - 2030 | Të paktën një takim në vit ku të ftohet shërbimi i Elbasanit dhe Tiranës që të shihet mundësia që kanë / nëse kanë për shërbim lëvizës, ose për këshillime online | 63,000 lekë (bashkia) | 63,000 lekë (bashkia) | 63,000 lekë (bashkia) | 63,000 lekë (bashkia) | 63,000 lekë (bashkia) | 63,000 lekë (bashkia) |
| **Objektivi specifik:** | **III.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore dhe promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".** | | | | | | | | | |
| **Treguesit:** | | | | | | **Baseline: (2025)** | | **Target: (2030)** | **MONITORIMI** | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| III.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. | Do përcaktohet | Rritur me 10% (2% çdo vit) | Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak. |
| III.2.b. Përqindja e grave, burrave, të rejave dhe të rinjve të përfshira/përfshirë në aktivitete që synojnë paqen, sigurinë dhe ndërtimin e komuniteteve të sigurta e gjithëpërfshirëse. | Do përcaktohet | Rritur me 10% (2% çdo vit) | |

| MASAT DHE AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | TREGUES | KOSTO (LEKË) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përgjegjës kryesor | Mbështetës | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
| III.2.1. Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese me nxënëse/nxënës, të rejat / të rinjtë dhe komunitetin në tërësi përgjatë gjithë vitit mbi format e ndryshme të DHBGJ | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëta re... | 2025 – 2030 | 6 aktivitete në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 73,400 lekë<br><br>(nga të cilat 24,660 lekë bashkia dhe 48,740 lekë hendek financiar) | 73,755 lekë<br><br>(nga të cilat 24,660 lekë bashkia dhe 49,095 lekë hendek financiar) | 73,755 lekë<br><br>(nga të cilat 24,660 lekë bashkia dhe 49,095 lekë hendek financiar) | 73,755 lekë<br><br>(nga të cilat 24,660 lekë bashkia dhe 49,095 lekë hendek financiar) | 73,755 lekë<br><br>(nga të cilat 24,660 lekë bashkia dhe 49,095 lekë hendek financiar) | 73,755 lekë<br><br>(nga të cilat 24,660 lekë bashkia dhe 49,095 lekë hendek financiar) |
| III.2.2.Organizimi i Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit kundër DHBGJ | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, | 2025 – 2030 | 1 fushatë në vit | 83,064 lekë<br><br>(nga të cilat 62,064 lekë | 188,988 lekë | 83,064 lekë<br><br>(nga të cilat 62,064 | 83,064 lekë<br><br>(nga të cilat 62,064 | 83,064 lekë<br><br>(nga të cilat 62,064 | 83,064 lekë<br><br>(nga të cilat 62,064 lekë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | organizata ndërkombëta re... | | | bashkia dhe 21,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 146,988 lekë bashkia dhe 42,000 lekë hendek financiar) | lekë bashkia dhe 21,000 lekë hendek financiar) | lekë bashkia dhe 21,000 lekë hendek financiar) | lekë bashkia dhe 21,000 lekë hendek financiar) | bashkia dhe 21,000 lekë hendek financiar) |
| III.2.3. Aktivitete të fokusuara vecanërisht te djemtë dhe burrat (takime, sesione mbi maskilizmin toksik, aktivitete në shkolla, etj). | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Anëtarët e MKR Pogradec, OJF, organizata ndërkombëta re | 2025 – 2030 | 6 aktivitete në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) |
| III.2.4. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe sensibilizuese në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas si dhe në ditë të tjera ndërkombëtare të shënuara | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Të gjitha drejtoritë dhe institucionet përkatëse në bashki | 2025 – 2030 | Çdo vit 1 aktivitet përgjatë javës së 8 Marsit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 21,000 lekë<br><br>(donatorë) | 21,000 lekë<br><br>(donatorë) | 21,000 lekë<br><br>(donatorë) | 21,000 lekë<br><br>(donatorë) | 21,000 lekë<br><br>(donatorë) | 21,000 lekë<br><br>(donatorë) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| III.2.5. Takime me të rejat dhe të rinjtë për shëndetin seksual dhe riprodhues | Qendra Arsimore, | ZVA, NJVKSH, Promocioni shëndetësor, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 3 takime në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 19,500 lekë<br><br>(bashkia) | 19,500 lekë<br><br>(bashkia) | 19,500 lekë<br><br>(bashkia) | 19,500 lekë<br><br>(bashkia) | 19,500 lekë<br><br>(bashkia) | 19,500 lekë<br><br>(bashkia) |
| III.2.6. Takime me gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, në të gjithë diversitetin e tyre, për të diskutuar mbi sëmundjen e kancerit të gjirit. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | NJVKSH, Promocioni shëndetësor, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 1 takim në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 41,000 lekë<br><br>(nga të cilat 12,600 lekë bashkia, 25,000 lekë donatorë dhe 3,500 leke hendek financiar) | 41,000 lekë<br><br>(nga të cilat 22,600 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 3,500 leke hendek financiar) | 41,000 lekë<br><br>(nga të cilat 22,600 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 3,500 leke hendek financiar) | 41,000 lekë<br><br>(nga të cilat 22,600 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 3,500 leke hendek financiar) | 41,000 lekë<br><br>(nga të cilat 22,600 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 3,500 leke hendek financiar) | 41,000 lekë<br><br>(nga të cilat 22,600 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 3,500 leke hendek financiar) |
| III.2.7. Takime me prindërit e rinj (nëna dhe baballarë) për kujdesin për foshnjat. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | NJVKSH, Promocioni shëndetësor, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 - 2030 | 1 takim në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 27,900 lekë<br><br>(nga të cilat 9,900 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë) | 27,900 lekë<br><br>(nga të cilat 9,900 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë) | 27,900 lekë<br><br>(nga të cilat 9,900 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë) | 27,900 lekë<br><br>(nga të cilat 9,900 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë) | 27,900 lekë<br><br>(nga të cilat 9,900 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë) | 27,900 lekë<br><br>(nga të cilat 9,900 lekë bashkia dhe 18,000 lekë donatorë) |
| III.2.8. Takime informuese mbi traditat dhe historinë | Drejtoria e Turizmit, | Këshilltari i Mediave, | 2027 - | 1 takim në vit | N/a | N/a | 31,000 lekë | 31,000 lekë | 42,915 lekë | 42,915 lekë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| e Pogradecit, si dhe rolin e grave/të rejave e burrave/të rinjve në përcjelljen e kulturës dhe qytetarisë pogradecare. | Trashëgimisë Kulturore dhe Rinisë | ZVA, OJF, organizatat ndërkombëtare | 2030 | Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | | | (bashkia) | (bashkia) | (bashkia) | (bashkia) |
| III.2.9. Informim dhe njohje me legjislacionin e shërbimet për gratë dhe të rejat migrante të kthyera. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 1 takim në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 27,420 lekë<br><br>(nga të cilat 6,120 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 6,300 lekë hendek financiar) | 27,420 lekë<br><br>(nga të cilat 6,120 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 6,300 lekë hendek financiar) | 27,420 lekë<br><br>(nga të cilat 6,120 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 6,300 lekë hendek financiar) | 27,420 lekë<br><br>(nga të cilat 6,120 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 6,300 lekë hendek financiar) | 27,420 lekë<br><br>(nga të cilat 6,120 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 6,300 lekë hendek financiar) | 27,420 lekë<br><br>(nga të cilat 6,120 lekë bashkia, 15,000 lekë donatorë dhe 6,300 lekë hendek financiar) |
| III.2.10. Sigurimi i mbështetjes psikologjike dhe sociale për gratë/të rejat që rikthehen, të cilat mund të kenë përjetuar stres dhe trauma gjatë periudhës së migrimit | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | OJF, organizatat ndërkombëtare | 2025 - 2030 | Numri i personave që u është siguruarmbështetje psikologjike dhe sociale, ndarë sipas moshës, vendbanimit, etj. | 20,658 lekë<br><br>(bashkia) | 20,658 lekë<br><br>(bashkia) | 20,658 lekë<br><br>(bashkia) | 20,658 lekë<br><br>(bashkia) | 20,658 lekë<br><br>(bashkia) | 20,658 lekë<br><br>(bashkia) |
| III.2.11. Bashkëpunimi me gratë/të rejat në diasporë dhe shkëmbim idesh e | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | OJF, organizatat | 2025 - 2030 | Numri i takimeve, lista e ideve | 27,060 lekë | 27,060 lekë | 27,060 lekë | 27,060 lekë | 27,060 lekë | 27,060 lekë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| përvojash për fuqizimin e grave dhe të rejave në Pogradec, etj. | | ndërkombëta re | | nga këto takime, etj | (nga të cilat 12,060 lekë bashkia dhe 15,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 12,060 lekë bashkia dhe 15,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 12,060 lekë bashkia dhe 15,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 12,060 lekë bashkia dhe 15,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 12,060 lekë bashkia dhe 15,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 12,060 lekë bashkia dhe 15,000 lekë hendek financiar) |
| III.2.12. Trajnimi dhe përmirësimi i aftësive profesionale të edukatoreve në çerdhe e kopshte, me fokus edukimin dhe barazinë gjinore. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | MAS, OJF, organizata ndërkombëta re... | 2026 – 2030 | 1 trajnim në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | N/a | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) | 2,155 lekë<br><br>(bashkia) |
| III.2.13. Takime informuese dhe fuqizimi i kapaciteteve të të rejave dhe të rinjve për njohjen dhe zbatimin e agjendës së paqes, sigurisë dhe barazisë gjinore. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | OJF, organizata ndërkombëta re... | 2025 – 2030 | 1 aktivitet në vit<br><br>Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) |
| III.2.14. Nxitja e organizimit të aktiviteteve mbi paqen, sigurinë dhe barazinë gjinore nga vetë të rejat dhe të rinjtë. | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | ZVA, OJF, organizata ndërkombëta re... | 2025 – 2030 | (1 aktivitet të bëhet nga vetë të rejat/rinjtë cdo vit. | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) | 13,792 lekë<br><br>(bashkia) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Të dhënat e ndara sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **Fusha e ndërhyrjes (Objektivi strategjik):** | **IV. INTEGRIMI GJINOR NË POLITIKAT VENDORE.** |
| **Rezultatet e pritshme:** | IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.<br>IV.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integrimi gjinor i reflektuar në politikat dhe planet e bashkisë. |
| **Dokumentet kryesore që u referohemi:** | - Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality) - nenet 4, 5, 7, 8, 9.<br>- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) - neni 3.<br>- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA) - fusha kritike 8.<br>- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – nenet 6, 8.<br>- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtyllat 1, 5.<br>- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – objektivi specifik IV.3. |
| **Objektivi specifik:** | **IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.** |

| **Treguesit:** | **Baseline: (2025)** | **Target: (2030)** | **MONITORIMI** |
|---|---|---|---|
| IV.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore, të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe të publikuara në faqen zyrtare të bashkisë dhe në Atlasin e Nënshkruesve të Kartës Evropiane për Barazi, të Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE). | 0 | 5<br>(1 çdo vit) | Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Evropian, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak. | |

| MASAT DHE AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | TREGUES | KOSTO (LEKË) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përgjegjës kryesor | Mbështetës | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
| IV.1.1. Ngritja e një Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie (për koordinim të zbatimit të këtij PVVBGJ dhe bashkëpunim me Komisionin e BGJ në nivel të Këshillit Bashkiak). | Kabineti i Kryetarit | Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse | 2025 | Komisioni i ngritur dhe funksional (pas miratimit të PVVBGJ në KB) | 2,586 lekë (bashkia) | N/a | N/a | N/a | N/a | N/a |
| IV.1.2. Takime të rregullta të Komisionit për BGJ në nivel bashkie për mbarëvajtjen e zbatimit të PVVBGJ. | Drejtoria e Kujdesit Social | Antarët e Komisionit për BGJ në nivel bashkie | 2025 – 2030 | Të paktën 4 herë në vit që të ndiqet rregullisht ecuria e zbatimit të planit | 3,448 lekë (bashkia) | 3,448 lekë (bashkia) | 3,448 lekë (bashkia) | 3,448 lekë (bashkia) | 3,448 lekë (bashkia) | 3,448 lekë (bashkia) |
| IV.1.3. Shtimi i një faqeje (seksioni) interneti të dedikuar për barazinë gjinore dhe krijimi i lidhjes së saj me faqen e internetit të bashkisë, si dhe përditësimi rregullisht me informacionet e duhura | Këshilltari për Mediat dhe Publikun | Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Shërbimeve Sociale | 2025 - 2030 | Faqja (seksioni) i shtuar dhe përditësuar me informacione rregullisht | 106,880 lekë (bashkia) | 106,880 lekë (bashkia) | 106,880 lekë (bashkia) | 106,880 lekë (bashkia) | 106,880 lekë (bashkia) | 106,880 lekë (bashkia) |
| IV.1.4. Fuqizimi i kapaciteteve të stafit të bashkisë për të kryer | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Të gjitha drejtoritë dhe | 2025 – 2030 | 2 sesione mentorimi në vit | 78,000 lekë | 78,000 lekë | 78,000 lekë | 78,000 lekë | 78,000 lekë | 78,000 lekë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| monitorimin e brendshëm në mënyrë të rregullt, për zbatimin e PVVBGJ | | institucionet përkatëse në bashki | | | (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë donatorë) | (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë donatorë) | (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë donatorë) | (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë donatorë) | (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë donatorë) | (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 60,000 lekë donatorë) |
| IV.1.5. Hartimi i raporteve periodike vjetore mbi progresin në zbatimin e PVVBGJ | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Të gjitha drejtoritë dhe institucionet përkatëse në bashki | 2025 – 2030 | 1 raport në vit | 19,550 lekë (bashkia) | 19,550 lekë (bashkia) | 19,550 lekë (bashkia) | 19,550 lekë (bashkia) | 19,550 lekë (bashkia) | 19,550 lekë (bashkia) |
| IV.1.6. Vlerësimi i zbatimit të PVVBGJ pas tre viteve dhe rishikimi/përshtatja sipas nevojës | Drejtoria e Shërbimeve Sociale | Të gjitha drejtoritë dhe institucionet përkatëse në bashki, OJF, partnerët, organzatat ndërkombëtare | 2028 | 1 raport vlerësimi | N/a | N/a | N/a | 48,000 lekë (nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 30,000 lekë hendek financiar) | N/a | N/a |

| **Objektivi specifik:** | **IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.** | | |
|---|---|---|---|
| **Treguesit:** | **Baseline: (2025)** | **Target: (2030)** | **MONITORIMI** |
| IV.2.a. Numri i programeve buxhetore të analizuara nën këndvështrimin gjinor. | 0 | 5 | Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| IV.2.b. Përqindja e buxhetit vjetor të bashkisë e dedikuar për zbatimin e PVVBGJ, dhe norma vjetore e rritjes së tij, krahasuar me përqindjen e buxhetit të shpenzuar për këtë qëllim. | 0 | Rritur me 1% çdo vit | Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian, si dhe anëtaret/anëtarët e Këshillit Bashkiak. |

| MASAT DHE AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | TREGUES | KOSTO (LEKË) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përgjegjës kryesor | Mbështetës | | | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 | 2030 |
| IV.2.1. Takime informuese për nxitjen e pjesmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, në dëgjimet publike duke vlerësuar mendimin e tyre. | Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar | Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Njësitë Administrative, OJF, organizata ndërkombëtare... | 2025 – 2030 | 3 takime në vit<br><br>Numri i personave ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | 7,500 lekë (donatorë) | 7,500 lekë (donatorë) | 7,500 lekë (donatorë) | 7,500 lekë (donatorë) | 7,500 lekë (donatorë) | 7,500 lekë (donatorë) |
| IV.2.2. Fuqizimi i kapaciteteve të stafit të bashkisë për përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore në dokumentet zyrtare dhe faqet e internetit të bashkisë. | Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve | Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, OJF, | 2025 – 2030 | 1 trajnim në vit<br><br>Numri i personave ndarë sipas seksit, moshës, etnisë, | 24,136 lekë (bashkia) | 24,136 lekë (bashkia) | 24,136 lekë (bashkia) | 24,136 lekë (bashkia) | 24,136 lekë (bashkia) | 24,136 lekë (bashkia) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | organizatat ndërkombëtare | | vendbanimit, etj. | | | | | | |
| IV.2.3. Ndryshimi i rregullores për formimin e grupeve të punës ku të përfshihet detyrimisht edhe NBGJ, si mundësi për të integruar perspektivën gjinore në cdo plan apo strategji që përgatitet nga bashkia | Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve | Të gjitha drejtoritë e bashkisë që hartojnë strategji dhe plane | 2025 | Rregullorja e ndryshuar<br><br>Perspektiva gjinore e integruar | 16,800 lekë<br><br>(bashkia) | N/a | N/a | N/a | N/a | N/a |
| IV.2.4. Fuqizimi i kapaciteteve të specialistes/specialistit të statistikave dhe punonjëseve / punonjësve të sektorëve të tjerë për plotësimin e tabelave me treguesit gjinorë. | Drejtoria e Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve | Drejtoria e Shërbimeve Sociale, OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 - 2027 | Numri i sesioneve mentoruese, sipas nevojës | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | 10,344 lekë<br><br>(bashkia) | N/a | N/a | N/a |
| IV.2.5. Trajnime mbi Integrimin Gjinor dhe Vlerësimin e Ndikimit Gjinor si dhe mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor. | Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar | Drejtoria e Shërbimeve Sociale, ASPA, MF, OJF, organizata ndërkombëtare | 2025 – 2030 | 1 trajnim në vit<br><br>Numri i personave ndarë sipas seksit, moshës, pozicionit, etj. | 56,400 lekë<br><br>(nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 38,400 lekë hendek financiar) | 56,400 lekë<br><br>(nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 38,400 lekë hendek financiar) | 56,400 lekë<br><br>(nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 38,400 lekë hendek financiar) | 8,400 lekë<br><br>(hendek financiar) | 86,400 lekë<br><br>(nga të cilat 18,000 lekë bashkia dhe 68,400 lekë hendek financiar) | 8,400 lekë<br><br>(hendek financiar) |
| IV.2.6. Analiza gjinore e programeve buxhetore të bashkisë. | Drejtoria Ekonomike dhe | Të gjitha drejtoritë në bashki, | 2025 – 2030 | 1 program buxhetor në vit | 75,860 lekë | 75,860 lekë | 75,860 lekë | 75,860 lekë | 75,860 lekë | 75,860 lekë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Menaxhimit Financiar | programet buxhetore të të cilave do analizohen, OJF, organizata ndërkombëta re | | | (nga të cilat 25,860 lekë bashkia dhe 50,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 25,860 lekë bashkia dhe 50,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 25,860 lekë bashkia dhe 50,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 25,860 lekë bashkia dhe 50,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 25,860 lekë bashkia dhe 50,000 lekë hendek financiar) | (nga të cilat 25,860 lekë bashkia dhe 50,000 lekë hendek financiar) |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA POGRADEC**

**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr.3150/Prot                                                                 Pogradec, më 21.08.2025
/5

**RELACION**
**MBI PROJEKT-VENDIMIN**
**PËR**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE TË BASHKISË POGRADEC",**

***Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:***

***Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:***

1) Akte administrative me karakter normativ
2) Akte administrative me karakter individual
3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, "Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."
Po kështu, në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: ""*Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore".*

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja "a" përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.
Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.
Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Proçedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:
*"Akt normativ nënligjor"* është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".
Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. "Akti administrativ":
**a)** "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

**b)** "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
Akti normativ përcakton rregulla për një situate abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektesh.
Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin sjell efekt juridike, e do të ketë një ndikim të rëndësishëm, pasi përcakton detyrime dhe përgjegjësi për organet e Bashkisë në zbatimin e masave të parashikuara, për një zhvillim të qëndrueshëm drejt barazisë gjinore, i cili synon të shërbejë si mjeti kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore si dhe në përputhje dhe zbatim të Strategjisë Kombëtare për barazinë Gjinore 2021-2023, i cili mundëson harmonizimin e veprimeve vendore me asquis të BE-së për barazinë gjinore, në rrugetimin e Bashkisë Pogradec drejt integrimit evropian. Projekt-vendimi në fjalë, duke miratuar një Plan Veprimi për Barazinë Gjinore, vendos objektiva, masa dhe afate kohore për zbatimin e politikave të barazisë gjinore në territorin e Bashkisë Pogradec. Ky plan synon të rregullojë një fushë të caktuar të marrëdhënieve shoqërore, duke i dhënë detyra konkrete strukturave të bashkisë dhe duke orientuar veprimtarinë e saj për një periudhë 6-vjeçare.

***Përfundimisht konkludojmë se***: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korcë, sipas ligjit.
**Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE**

**KRYETAR**

**Ilir XHAKOLLI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

**Procesverbal**

**Konsultim publik :**

**Data** : 19/08/2025 **Ora** : 12 :00

**Vendi:** Salla e Këshillit Bashkiak

**Numri i pjesëmarrësve** : Gjithësej 19 persona të pranishëm

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet** :

"Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025 – 2030 të Bashkisë Pogradec"

**Pjesëmarrës :**

| | |
|---|---|
| Manjola Kamolli | ( Kryetare e Këshillit ) |
| Albana Prifti | (Zv Kryetare e Këshillit ) |
| Marjeta Biba | (Këshilltare) |
| Vjollca Pllaha | (Këshilltare) |
| Mimoza Shuli | (Këshilltare) |
| Entela Gusho | Zv Kryetare e Bashkisë |
| Ivana Llakmani | Drejtore, Drejtoria e Shërbimeve Sociale |

**Manjola Kamolli ( Kryetare e Këshillit ) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

-Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.
-Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.

-Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
-Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
-Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.

**Entela Gusho :** Përshëndetje të gjithëve. Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në prezantimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore. Ky është një plan shumë I rëndësishëm për të gjithë Bashkinë I cili ka filluar punën nga muaji Shkurt. Në planin e kaluar kemi plotësuar me sukses të gjitha objektivat dhe jemi një nga Bashkitë më të suksesshme në zhvillimin dhe aplikimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore. Do të na ndihmonin dhe do ti vlerësonim shumë mendimet e juaja në lidhje me planin.

**Manjola Kamolli:** Të nderuara pjesëmmarëse, jemi mbledhur për të zhvilluar konsultimin public në bashkëpunim me Bashkinë dhe për të dëgjuar mendimet dhe sygjerimet e juaja. Barazia Gjinore nuk është vetëm një detyrim ligjor por një domosdoshmëri. . Dua të falenderoj gjithashtu grupin e punës për punën e palodhur.

**Ivana Capollari:** Po filloj me prezantimin shkurtimisht të planit.

Plani I Veprimit për Barazinë Gjinore është udhërrëfyesi ynë për të ndërtuar një Pogradec ku gratë dhe burrat , vajzat dhe djemtë, kanë mundësi të barabarta në cdo fushë të jetës. Ky nuk është thjesht një dokument , por vullneti jonë politik për ta bërë barazinë gjinore një realitet të prekshëm për të gjithë. Plani është hartuar nga Bashkia Pogradec në përputhje me Strategjinë Kombëtare dhe kartën Europiane për barazi. Është një punë e përbashkët me mbështetjen e UN Women dhe Bashkimit Europian.

Vizioni ynë I përbashkët është një Pogradec ku të gjithë qytetarët , pavarësisht moshës, vendbanimit aftësive apo cdo karakteristike tjetër , gëzojnë respektojnë, dhe kontribuojnë për barazi gjinore reale në cdo aspekt të jetës.

Arbri Basho: Fushat ku do të përqëndrohemi pra 4 fushat kryesore të veprimit janë:

1-Fuqizimi Ekonomik dhe Social, që do të thotë më shumë mundësi punësimi dhe sipërmarrje për gratë dhe të rejat.

2-Rritja e pjesëmarrjes në vendimarrje: Më shumë gra dhe të rinj në pozicione drejtuese në nivel vendor.

3- Një jetë e lirë nga dhuna: Parandalimi dhe lufta kundër dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje.

4-Barazia Gjinore në të gjitha politikat vendore: Integrimi I këndvështrimit gjinor në cdo plan, buxhet dhe shërbim të përbashkët.

Përsa I përket monitorimit  e kemi menduar ta realizojmë nëpërmjet 4 pikave kryesore të cilat janë:

-Raportimi I Rregullt

-Monitorimi nga Këshilli Bashkiak

-Transparenca

-Rishikimi Vjetor.

Kjo ishte një përmbledhje shkurtimisht e  Planit të Veprimit të Barazisë Gjinore. Mirëpresim mendimet dhe sygjerimet e juaja.

Albana Prifti: Dua të falenderoj grupin e punës për të gjithë punën e realizuar. Ne e dimë se cështja e barazisë gjinore është një cështje shumë e rëndësishme në shoqërinë tonë. Të gjitha aktivitetet e planifikuara mu dukën shumë interesante., gjithashtu dhe politikat për të nxitur gratë dhe vajzat.

Fjorela Xhindole: Ne bëjmë një plan në fillim të vitit për të gjitha aktivitetet që do të zhvillojmë.

Mimoza Shuli: Unë kam  kënaqësi të bashkëpunoj më drejtorinë tuaj. E krahasoj me drejtoritë  e tjera të qarkut te Korcës dhe për mua keni një vlerësim pasi bëni një punë që ju diferencon.Doja të thoja të filloni sa më shpejt në mënyrë që të përfitoni ngga projektet.

Marjeta Biba: Unë doja të ndalesha pak te plani I aktiviteteve për shkollat. Do të ishte mirë që aktivitetet të prezantohen që në fillim të vitit për të koordinuar planet.

Shpresa Blacëri: Shohim që është një plan ambicioz, doja të sygjeroja më shumë vëmëndje te gratë artizane gjithashtu fokusin ta vendosim  te gratë si kryetare fshati.

Afroviti Gusho: Doja të përmendja disa pika kyce që mu dukën shumë të rëndësishme sic janë përfshirja e grave në zonat rurale, përfshirja e planeve në shkollat, dhe promovimi I grave në pozicione drejtuese në zonat rurale.

**SEKRETARE E KËSHILLIT**

**Jona BOJKO**